



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____2021

VENDIM
Nr. 298, datë 13.07.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shumë mirë”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARES

Tiranë më 13.07.2021

EKSTRAKT

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR {...}DO KRITER VLERËSIMI.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekte, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e {...}ështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të {...}ështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e {...}ështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit. Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e {...}ështjes në 8 vendimet e analizuara, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil apo seancë paraprake*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar, faktet parashtrihen gjithmonë në pjesën e dytë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit. Përshkrimi i rrethanave dhe fakteve të {...}ështjes, në bazë të kategorisë së {...}ështjes

(civile themeli, urdhër mbrojtje, kërkesë për pushimin e procedimit ose kërkesë për dërgim në gjyq), është i qartë dhe bëhet duke integruar edhe provat prej të cilave rezultojnë ato. Në një rast gjyqtarja nuk përshkruan faktet e {...}ështjes, por përshkruan rrethanat procedurale, për shkak të natyrës së disponimit të gjykatës për kthimin e kërkesëpadisë palës paditëse, në kushtet kur padia paraqitet me të meta thelbësore.¹

Lidhur me përcaktimin e natyrës së {...}ështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton natyrën e {...}ështjes objekt shqyrtimi në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit.

Në vendimet civile - Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtares, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e {...}ështjes.

Në vendimet penale – gjyqtarja përcakton natyrën e {...}ështjes dhe fazën procedurale në të cilën është {...}ështja objekt gjykimi (*seancë paraprake - dërgim në gjyq ose kërkesë për pushimin e procedimit*), duke cituar për këtë qëllim në mënyrë specifike edhe dispozitat procedurale të ndryshuara me ligjin nr. 35/2017 në lidhje me detyrat e gjyqtares të seancës paraprake.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezulton se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e {...}ështjes, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*mosmarrëveshje pronësie, kthim shume apo urdhër mbrojtje*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e {...}ështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse.

- Në vendimin nr. 858, datë 19.11.2019 (*me objekt kthim shume*), gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale (*nenet 608, 609, 419, 420, 421, 445, 446 të K.Civil*) lidhur me përgjegjësinë për shkaktimin e dënimit, kuptimin e detyrimit, lindjen e detyrimit, natyrën ekonomike të detyrimit dhe të detyrimeve monetare, si dhe dispozitën materiale (*nenin 135 të K.Penal*), me qëllim evidentimin e veprimeve të kundërligjshme të të paditurit;
- Në vendimin nr. 238, datë 03.04.2019 (*me objekt urdhër mbrojtje*), gjyqtarja identifikon dispozitat materiale të ligjit të posa{...}ëm, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (*nenin 3*), në lidhje me kategorinë e subjekteve që merren në mbrojtje në kuadër të këtij ligji, si dhe (*nenin 15*) lidhur me diskrecionin e gjykatës për të disponuar në bazë të bindjes së brendshme.

¹ Vendimi nr. 8793, datë 26.12.2019;

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës;² citimi dhe zbatimi i dispozitave procedurale civile (*nenin 511/{...} të K.Pr.Civile*), në lidhje me mënyrën e procedimit të shqyrtimit të kërkesës;³ citon dispozitat ligjore procedurale (*nenet 154 dhe 156 të K.Pr.Civile, ndryshuar me ligjin nr.38/2017*) lidhur me elementët e domosdoshëm të ngritjes së padisë dhe aktet që duhet t'i bashkëlidhen padisë.⁴

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal. Konkretisht, në vendimin nr. 457, datë 24.12.2019 (*me objekt kërkesë për dërgimin e {...}ështjes në gjyq*), identifikon dispozitat ligjore materiale (*nenet 89, 113/1, 113/2 dhe 114/1 të K.Penal*), në lidhje me ekzistencën e faktit penal; në vendimin nr. 203, datë 13.05.2019 (*me objekt kërkesë për pushimin e procedimit penal*), citon dispozitën materiale (*nenin 186 të K.Penal*), me qëllim për të konstatuar nëse jemi para konsumimit të kësaj vepre penale nga personi ndaj të cilit janë zhvilluar hetimet.

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale penale (*nenet 328 dhe 329/a të K.Pr.Penale*) lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale, disponimin e prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake dhe kërkesën për pushimin e {...}ështjes;⁵ (*nenet 331, 332/ë/1 dhe 327 të K.Pr.Penale*), lidhur me elementët e domosdoshëm të kërkesës për dërgimin e {...}ështjes në gjyq, përmbajtjen e fashikullit të gjykimit, si dhe disponimin e prokurorit në fund të hetimeve paraprake, në funksion të mënyrës së zgjidhjes së {...}ështjes;⁶ (*nenet 69, 75/a, 76, 13/2/{...} të K.Pr.Penale*) në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e {...}ështjes, (*nenin 403 të K.Pr.Penale*) në funksion të pranimit procedural për shqyrtim të kërkesës për gjykim të shkurtuar të paraqitur nga i pandehuri, gjatë shqyrtimit të kërkesës për dërgimin në gjyq.⁷

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezulton të jetë evidentuar konflikt i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së {...}ështjeve të trajtuara.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të {...}ështjes dhe bën përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

²Vendimi nr. 238, datë 03.04.2019;

³ Vendimi nr. 23 datë 24.01.2019;

⁴ Vendimi nr. 973, datë 19.12.2019;

⁵ Vendimi nr. 253, datë 11.07.2019; Vendimi nr. 337, datë 09.10.2019; Vendimi nr. 203, datë 13.05.2019;

⁶ Vendimi nr. 457, datë 24.12.2019;

⁷ Vendimi nr. 457, datë 24.12.2019;

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e {...}ështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e {...}ështjes. Në {...}do rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Konkretisht, rezulton të jenë interpretuar dispozitat ligjore materiale si më poshtë:

- Gjyqtarja interpreton dispozitat materiale, nenin 608 të K.Civil, lidhur me dëmin jashtëkontraktor dhe elementët e tij, nenin 135 të K.Penal, për të konkluduar mbi veprimet e paligjshme të të paditurit;⁸
- Interpreton dispozitën materiale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke interpretuar elementët domosdoshëm të saj (*objektin, anën objektive, anën subjektive dhe subjektin*), si dhe natyrën blankete të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e cila referon shkeljen në ligje dhe akte të tjera nënligjore, që normojnë punën e personit që ushtron një funksion publik;⁹
- Gjyqtarja interpreton dispozitat materiale të ligjit të posa{...}ëm, nenin 3 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në lidhje me kategorinë e subjekteve që merren në mbrojtje në kuadër të këtij ligji, nenin 3 për të përcaktuar se cilat veprime dhe mosveprime do të kualifikohen si “dhunë” në kuptim të këtij ligji për të gëzuar mbrojtje pala e dhunuar, si dhe nenin 15 të po këtij ligji lidhur me diskrecionin e gjykatës për të disponuar në bazë të bindjes së brendshme;¹⁰
- Gjyqtarja interpreton dispozitën materiale “Falsifikimi i dokumentit”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke interpretuar elementët domosdoshëm të saj (*objektin, anën objektive, anën subjektive dhe subjektin*), si dhe duke i aplikuar mbi faktet e {...}ështjes.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtarja interpreton në përputhje me rrethanat e faktit, dispozitat procedurale si me poshtë:

- Nenin 329 të K.Pr.Penale, në raport me dispozitat e tjera procedurale dhe kushtetuese, me qëllim përcaktimin e pozicionit dhe rolit të prokurorisë në hetimet paraprake, si dhe kontrollin e kësaj veprimtarie nga gjykata; nenin 152 të K.Pr.Penale, lidhur me

⁸ Vendimi nr. 858, datë 19.11.2019;

⁹ Vendimi nr. 337, datë 09.10.2019;

¹⁰ Vendimi nr. 238, datë 03.04.2019;

{...}muarjen e provave, duke argumentuar se vendimmarrja gjyqësore është konkluzion përfundimtar i procesit të {...}mimit të provave dhe se analiza e provave përqendrohet në vërtetësinë e fakteve objekt prove dhe fuqinë provuese të tyre;¹¹

- Nenet 61 dhe 70 të K.Pr.Penale, lidhur me padinë civile në procesin penal dhe efektet e vendimit penal në gjykimin civil dhe administrativ, mbi faktet e {...}ështëjes ka konkluduar mbi ekzistencën e dëmit jopasuror;¹²
- Nenet 154 dhe 156 të K.Pr.Civile, ndryshuar me ligjin nr.38/2017, me qëllim analizimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në gjykim, të cilat lindin në momentin e depozitimit në gjykatë të një padie;¹³
- Nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës. Në përcaktimin e kompetencës lëndore gjykata mban parasysh edhe parashikimin e nenit 13/2 pika "{...}" të K.Pr.Penale, të interpretuar konform jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur se: "...frazë "gjykatë e caktuar me ligj" në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e {...}do {...}ështëje konkrete", duke referuar në Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 18.05.2005 dhe nr.14, datë 17.04.2007.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e {...}ështëjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, si {...} janë: parimi i ligjshmërisë, parimi i kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor dhe parimi i proporcionalitetit.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, në shumicën e vendimeve të analizuar rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posa {...}ërisht në rastet:

- me qëllim analizimin e interesit të ligjshëm, gjykata referon në Vendimin Unifikues nr.12, datë 14.09.2007, të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar se {...}do subjekt i së drejtës që cenohet në të drejtat dhe interesat e ligjshme personale apo pasurore nga një fakt i paligjshëm, ka të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror;
- në përcaktimin e kompetencës lëndore gjyqtarja mban parasysh edhe parashikimin e nenit 13/2 pika "{...}" të K.Pr.Penale, të interpretuar konform jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, duke u referuar në vendimet nr.12, datë 18.05.2005 dhe nr.14, datë 17.04.2007.

¹¹ Vendimi nr. 253, datë 11.07.2019;

¹² Vendimi nr. 858, datë 19.11.2019;

¹³ Vendimi nr. 973, datë 19.12.2019;

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me {...} është dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e {...} është” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet përfundimtare, në përgjithësi është e thjeshtë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në procesin civil, nuk evidentohet përdorimi i termave latinë, por parimet apo institutet përmenden në gjuhën shqipe.

Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve që mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Termet teknike janë përdorur në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i tyre.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në përgjithësi përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe {...}) në vendimet gjyqësore. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsytimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezulton që të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Vendimi është i organizuar me paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize, gjyqtarja ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Rezulton se gjyqtarja ka një metodologji të qartë, sipas pjesëve përbërëse të vendimit. Konkretisht, në mënyrë më specifike, konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, baza ligjore, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Në pjesën e vendimit ku pasqyrohet trupi gjykues, konstatohet që gjyqtarja vendos në vendim dy mbiemra: {...} ({...}eka). Referuar nenit 51 të Kodit të Familjes, bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre, ose të mbajnë secili mbiemrin e vet. Në certifikatën familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, me nr. 013396266, datë 06.02.2018, konstatohet që gjyqtarja ka zgjedhur të mbajë si mbiemër “Xhili”. Në zbatim të nenit 6§3 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i cili parashikon që elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të {...}do akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen, në pjesën e vendimit ku pasqyrohet trupi gjykues duhet të vendoset vetëm mbiemri “Xhili”.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar analizohen: (i) procedura, (ii) faktet e {...}ështjes (iii) legjislacioni i zbatueshëm (iv) arsyetimi i gjykatës, ku në mënyrë të detajuar gjyqtarja analizon procedurën ligjore të ndjekur nga gjykata nga marrja e dosjes në dorëzim, faktet e {...}ështjes të integruar me provat, dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në {...}ështjen konkrete, si dhe kryen analizën ligjore të legjislacionit të zbatueshëm, të aplikuar mbi faktet e {...}ështjes.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Në vendimet civile dispozitivi i vendimit është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës, por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore apo parashikimi i titullit ekzekutiv të vendimit, me marrjen formë të prerë të tij, sipas

ndryshimeve në K.Pr.Civile. Nga ana tjetër, konstatohet se në pjesën e dispozitivit të dërgimit të {...}ështjes në gjyq, gjyqtarja parashikon edhe faktin që ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankimi, për t'u bërë i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit që vendimi nuk mund të ankimohet.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale, si dhe nenin 332/e të K.Pr.Penale, në vendimin për dërgimin e {...}ështjes në gjyq.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të {...}ështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtares për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të {...}ështjes, si dhe kategorisë së {...}ështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e {...}ështjes, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse. Kjo analizë e integruar rezulton ve {...}anërisht në disa vendime, si më poshtë:

- Referuar natyrës së kërkesës, gjyqtarja analizon ndryshimet e bëra në ligjin procedural penale, konkretisht nenin 329/a të K.Pr.Penale, duke analizuar se prokuroria mund t'i drejtohet gjyqtares të seancës paraprake me kërkesë për pushimin e {...}ështjes apo të akuzës, në rastet kur procedohet për krime. Në kuptim të këtyre dispozitave, gjyqtarja ka analizuar legjimitetin e prokurorisë në paraqitjen e kërkesës për pushimin e {...}ështjes. Po kështu, gjyqtarja analizon veprimet hetimore të kryera nga prokuroria, duke vlerësuar se analiza ligjore e hetimeve paraprake mund të përqendrohet në tërësinë e veprimeve procedurale, në raport me veprën penale dhe tërësinë e rrethanave të kryerjes së saj.

Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së kontrollit të gjykatës mbi veprimet e prokurorit për kërkesën për pushimin e procedimit penal, duke argumentuar se një gjykim i drejtë jepet duke {...}muar dhe vlerësuar jo vetëm aktet procedurale të organit të hetimit, por edhe prova të tjera që mund të paraqesin palët e interesuara (*personi i dyshuar, viktima etj.*). Në këtë kontekst, gjyqtarja analizon se prokuroria duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë, duke kryer një hetim të plotë, të gjithanshëm, objektiv, duke u dhënë përgjigje të gjitha paqartësive që mund të dalin gjatë hetimeve, për të arritur më pas në një përfundim të drejtë, të bazuar në ligj e në prova;¹⁴

- Gjyqtarja analizon institutin e dëmit jashtëkontraktor dhe elementët e tij, duke arsyetuar se shkaktimi i dëmit është një nga rastet e përcaktuara në legjisllacionin civil për krijimin e detyrimit dhe se që të ketë dëm jashtëkontraktor, është e nevojshme që të plotësohen këto kushte: ekzistenca e fajit, dëmi i shkaktuar, paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit dhe lidhja shkakësore. Gjyqtarja përkufizon konceptin juridik të fajit, sipas të drejtës penale, duke arsyetuar se “faj” do të konsiderohet kryerja e veprimit ose mosveprimit me dashje ose nga pakujdesia. Më tej gjyqtarja përkufizon karakterin e paligjshëm të veprimit ose mosveprimit, duke i identifikuar si veprime ose mosveprime, të cilat vijnë në kundërshtim me një normë urdhëruese të ligjit. Po kështu, gjyqtarja përkufizon ekzistencën e dëmit, duke nënkuptuar një dëm të padrejtë, që shkakton pakësimin e pasurisë së një personi dhe në vijim, pengesën që krijohet për shtimin e saj në të ardhmen, si dhe analizon faktin penal “*Vjedhja duke shpërdoruar detyrën*”, të parashikuar nga neni 135 i K.Penal, për të konkluduar mbi veprimet e paligjshme të të paditurit;¹⁵
- Gjyqtarja analizon institutet juridike të juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore, sipas neneve 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale. Duke analizuar natyrën e kërkesës, e cila rregullohet në mënyrë të shprehur në K.Pr.Penale, gjyqtarja ka konstatuar pasjen e juridiksionit për shqyrtimin gjyqësor të {...}ështjes. Gjyqtarja ka analizuar se ligjvënësi për të identifikuar gjykatën kompetente në lëndë, merr si kriter të vetëm llojin e veprës penale, si dhe në disa raste, subjektin aktiv të veprës penale, ose subjektin pasiv të saj, të përcaktuar në mënyrë shteruese në nenin 75/a të K.Pr.Penale. Gjithashtu, nisur nga territori në të cilin është kryer vepra penale, gjyqtarja ka konkluduar për pasjen e kompetencës tokësore për shqyrtimin e {...}ështjes. Në kuadër të vlerësimit të elementëve thelbësorë të kërkesës apo themelit të saj, gjyqtarja vlerëson se në rastet objekt gjykimi nuk mund të vlerësojë kryesisht ekzistencën e pavlefshmërisë relative të akteve. Referuar përmbajtjes së akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit në kuadër të parashikimeve të nenit 128/a të K.Pr.Penale, lidhur me rastet e pavlefshmërisë së akteve, të cilat duhet të konstatohen edhe kryesisht, gjyqtarja ka konstatuar se në rastin konkret nuk rezultojnë të jenë shkelur dispozitat ligjore lidhur me pavlefshmërinë absolute të akteve.¹⁶

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezultojnë se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret.

¹⁴ Vendimi nr. 253, datë 11.07.2019; Vendimi nr. 337, datë 09.10.2019; Vendimi nr. 203, datë 13.05.2019;

¹⁵ Vendimi nr. 858, datë 19.11.2019;

¹⁶ Vendimi nr. 457, datë 24.12.2019;

Sa i përket pretendimeve të palëve, ato marrin një përgjigje të argumentuar, duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar jo në një pjesë të ve{...}uar, por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, në aspektin e mbështetjes në ligj ose në prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsytimit të vendimit.

Në tërësi, në të gjitha vendimet e gjyqtares, analiza ligjore, si në lidhje me aspektet procedurale të zhvillimit të gjykimit, ashtu edhe në analizën ligjore të objektit në shqyrtim, zhvillohet e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 196 {...}ështëje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së {...}ështëjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, “Seancë paraprake” dhe “Kërkesa në fazën e ekzekutimit”. Duke iu referuar objektit të {...}ështëjeve të pasqyruara në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se kërkesat janë: me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbare”, për të cilat neni 610 i K.Pr.Civile, parashikon një afat prej 20 ditësh për përfundimin e gjykimit; me objekt “Lëshim i urdhrat të mbrojtjes”, për të cilën parashikohet një afat prej 15 ditësh për përfundimin e tyre, sipas ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; me objekt “Zëvendësim i masës së sigurimit”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 260 të K.Pr.Penale, duhet të

shqyrtohen brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës; me objekt “Ankim nga vendimit të mosfillimit të procedimit penal”, të cilat sipas nenit 291/3 të K.Pr.Penale duhet të shqyrtohen brenda një afati prej 30 ditësh; me objekt “Dërgim i {...}ështjes në gjyq”, të cilat sipas nenit 332 të K.Pr.Penale duhet të shqyrtohen brenda një afati prej 30 ditësh; me objekt “Ekzekutim letërporsie”, të cilat sipas nenit 506/3 të K.Pr.Penale duhet të shqyrtohen brenda 10 ditëve.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se nga 196 {...}ështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 22 (dhjetë)¹⁷ prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të {...}ështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (22 {...}ështje), me numrin total të {...}ështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (196 {...}ështje), gjyqtarja rezultojnë që të ketë gjykuar 11.2% të {...}ështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga gjykata, evidentohet se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur për shkak të pushimeve vjetore të gjyqtarës (*muaji gusht*).¹⁸ Konkretisht, në tabelën nr.11, {...}ështja me numër rendor 64, është regjistruar në datën 26.07.2019 dhe ka përfunduar në datën 10.09.2019 dhe nëse afati i gjykimit do të llogaritej pa përfshirë periudhën e pushimeve vjetore, atëherë kjo {...}ështje do të kishte përfunduar për 25 ditë, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 332 të K.Pr.Penale; Në tabelën nr.11, {...}ështja me numër rendor 65, është regjistruar në datën 29.07.2019 dhe është shortuar në datën 10.09.2019 dhe nëse afati i gjykimit do të llogaritej pa përfshirë periudhën e pushimeve vjetore, atëherë kjo {...}ështje do të kishte përfunduar për 22 ditë, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 332 të K.Pr.Penale.

Duke përjashtuar dy {...}ështjet e analizuar më sipër, rezultojnë se raporti i {...}ështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (20 {...}ështje), me numrin total të {...}ështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (196 {...}ështje), gjyqtarja rezultojnë që të ketë gjykuar 10.2% të {...}ështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja parashtron se në përgjithësi i kushton rëndësi të posaçme me respektimit të afateve ligjore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “0-10 %”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

¹⁷ Në Tabelën nr. 1 {...}ështjet me numër rendor 10; në Tabelën nr. 2 {...}ështjet me numër rendor 21, 30, 33; në Tabelën nr. 10 {...}ështjet me numër rendor 44, 62, 64, 77; në Tabelën nr. 11 {...}ështjet me numër rendor 13, 15, 29, 30, 53, 54, 59, 64, 65, 66, 67, 71, 79, 95.

¹⁸ Neni 23/5 i ligjit 96/2016 parashikon: “Pushimet vjetore mund të merren njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së magjistratit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Në {...}do rast, pushimet duhet të përfshijnë një periudhë trejavore pa ndërprerje, qatë muajit qusht, përveç{...} kur kërkesat e ushtrimit të funksionit kërkojnë vazhdimin e aktiviteteve të gjykatës ose prokurorisë”.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar në total 448 (katërqind e dyzetë e tetë) {...}ështje (pa përfshirë këtu {...}ështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi), nga të cilat 57 (pesëdhjetë e shtatë) {...}ështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë) {...}ështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, 83 (tetëdhjetë e tre) {...}ështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, 8 (tetë) {...}ështje të kategorisë “Familjare pa palë kundërshtare”, 1 (një) {...}ështje të kategorisë “Tregtare me palë kundërshtare”, 6 (gjashtë) {...}ështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, 80 (tetëdhjetë) {...}ështje të kategorisë “Penale krime”, 19 (nëntëmbëdhjetë) {...}ështje të kategorisë “Penale kundërvajtje”, 30 (tridhjetë) {...}ështje të kategorisë “Seancë paraprake” dhe 5 (pesë) {...}ështje të kategorisë “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së, përcakton këto standarde minimale kohore në gjykatën e shkallës së parë:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile dhe ato tregtare;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, rezulton se nga 448 {...}ështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 77 prej tyre ose 17.1% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor.

Evidentohet se {...}ështja me nr. 858 vendimi, datë 19.11.2019 (vendim i zgjedhur nga gjyqtarja për vlerësim), në tabelën me të dhënat statistikore, konkretisht në Tabelën nr.1, me numër rendor 44, është pasqyruar se gjykimi ka përfunduar për 1 (një) vit e 7 (shtatë) muaj, pra tej standardit minimal kohor në fuqi. Ndërkohë, referuar vendimit, rezulton se {...}ështja ka qenë për shqyrtim pranë një gjyqtareje tjetër, e cila është larguar me leje barrëindje dhe pas rihedhjes në short, {...}ështja i ka kaluar për gjykim gjyqtares {...} në shtator të vitit 2019. Pra, nëse i referohemi datës 01.09.2019, kur u caktua {...}ështja me short, si dhe datës 19.11.2019, të përfundimit të gjykimit, afati i gjykimit të {...}ështjes do të ishte 2 muaj e 18 ditë, pra brenda standardit minimal kohor.

Po kështu, evidentohet se gjykimi i {...}ështjes me nr. 863 vendimi, datë 21.11.2019, pasqyruar në Tabelën nr.1, me numër rendor 46, ka përfunduar për 5 (pesë) vjet 7 (shtatë) muaj e 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë, si dhe gjykimi i {...}ështjes me nr. 945 vendimi, datë 12.12.2019 pasqyruar në Tabelën nr.1, me numër rendor 52, ka përfunduar për 1 (një) vit 9 (nëntë) muaj e 13 (trembëdhjetë) ditë. Referuar natyrës së posaçësisht me të gjykimit të {...}ështjeve të pjesëtimit të pasurisë, rezulton se gjykimi i {...}ështjes me nr. 863 vendimi,

datë 21.11.2019 ka përfunduar për 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 7 (shtatë) ditë¹⁹ dhe gjykimi i {...}ështjes me nr. 945 vendimi, datë 12.12.2019 ka përfunduar për 10 (dhjetë) muaj e 7 ditë²⁰ (në afatin e gjykimit nuk është përfshirë periudha kohore gjatë të cilës është vijuar me procedurat për konfirmimin e formës së prerë të vendimit të fazës së parë të pjesëtimit, apo koha në të cilën {...}ështja ka qenë e pezulluar).

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të {...}ështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të {...}ështjeve të gjykuara (pa përfshirë këtu {...}ështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi), si dhe kohës relativisht të shkurtër të tejkalimit të standardit minimal kohor në shumicën e {...}ështjeve të analizuar sipas të dhënave statistikore, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi sesa ai që i përket përqindjes së {...}ështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e {...}ështjeve të shqyrtuara në tejkalim të standardit minimal kohor rezulton më e lartë se 10%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “0-10 %”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë {...}ështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të {...}ështjeve. Konkretisht:

Në kategorinë e {...}ështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 177.47 ditë (për tre {...}ështjet e analizuar më sipër koha e gjykimit është marrë ajo që ka rezultuar sipas analizës), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

¹⁹ Gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë ka zgjatuar 03.02.2014 -11.06.2014 dhe pas marrjes së vendimit të formës së prerë, gjykimi i fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë ka vijuar në datën 19.04.2016-17.11.2016, datë në të cilën është vendosur pezullimi i gjykimit për shkak se një nga palët ndërgjyqëse ka ndërruar jetë gjatë gjykimit të fazës së dytë të pjesëtimit;

²⁰ Gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë ka zgjatuar 29.03.2018 -19.11.2018 dhe pas marrjes së vendimit të formës së prerë, gjykimi i fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë ka vijuar në datën 27.02.2019-13.05.2019.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 17.9 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 99.7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 67 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Tregtare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 274 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 153.1 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Penale krime”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 58.1 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Penale kundërvajtje”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 59.7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Seancë paraprake”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 34.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e {...}ështjeve “Kërkesa në fazën e ekzekutimit”, koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështjeje është 45.8 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të {...}ështjeve”, duke e pikëzuar me 4 pikë.

2.A.{...} Rendimenti i përfundimit të {...}ështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të {...}ështjeve, si raport mes numrit të {...}ështjeve të përfunduara (644 {...}ështje), me numrin e {...}ështjeve të caktuara (635 {...}ështje) brenda vitit kalendarik, është 101.4 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është "+99%", duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të ve{...}anta {...}ështjesh është si më poshtë:

- Për {...}ështje të kategorisë "Civile të përgjithshme me palë kundërshtare", koha mesatare e arsytimit është 6.93 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për {...}ështje të kategorisë "Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare", koha mesatare e arsytimit është 4.58 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për {...}ështje të kategorisë "Familjare me palë kundërshtare", koha mesatare e arsytimit është 4.83 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për {...}ështje të kategorisë "Familjare pa palë kundërshtare", koha mesatare e arsytimit është 7.37 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për {...}ështje të kategorisë "Tregtare me palë kundërshtare", koha mesatare e arsytimit është 7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për {...}ështje të kategorisë "Marrëdhënie pune", koha mesatare e arsytimit është 9.16 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për {...}ështje të kategorisë "Penale krime", koha mesatare e arsytimit është 4.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështje të kategorisë "Penale kundërvajtje", koha mesatare e arsytimit është 5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështje të kategorisë "Kërkesa penale të hetimit paraprak", për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, si dhe zëvendësim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 3.35 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë, i parashikuar

nga nenet 249 dhe 260 e K.Pr.Penale.

- Për {...}ështëje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt verifikim kushtesh dhe kriteresh, koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë, i parashikuar nga neni 248/2 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështëje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vleftësim, lejim apo zgjatje e përgjimit, koha mesatare e arsyetimit është 3.1 ditë, pra më e gjatë se afati procedural prej 24 orësh, i parashikuar nga neni 222 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështëje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 4.2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështëje të kategorisë “Seancë paraprake”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt dërgim në gjyq, koha mesatare e arsyetimit është 3.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë, i parashikuar nga neni 332/dh paragrafi 2 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështëje të kategorisë “Seancë paraprake”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt kërkesë për pushimin e procedimit penal dhe kundërshtim vendim pushimi, koha mesatare e arsyetimit është 4.9 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për {...}ështëje të kategorisë “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 7.2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të {...}ështëjeve”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për {...}do kategori {...}ështëjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar Raportit Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, evidentohet se të dhënat lidhur me numrin e seancave gjyqësore për {...}do kategori {...}ështëjesh nuk janë të plota, duke u paraqitur në disa prej tyre me mungesë të kësaj të dhëne. Po kështu, evidentohet se në {...}ështëjet e përzgjedhura me short

dhe të pasqyruara në tabelat përkatëse numri i seancave gjyqësore të zhvilluara për shqyrtimin e {...}ështjes, nuk përputhet me numrin e seancave të pasqyruar në kolonën “Nr. i seancave gjyqësore”. Konkretisht, në tabelën nr. 1, {...}ështja me numër rendor 58, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 5 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 973 vendimi, datë 19.12.2019, rezulton se nuk është zhvilluar seancë gjyqësore.

Në kushtet kur në të dhënat e dërguara nga gjykata paraqiten me mangësi lidhur me numrin e seancave gjyqësore, kjo për shkak se informacioni lidhur me seancat gjyqësore të zhvilluara për {...}do {...}ështje nuk mund të gjenerohet në mënyrë elektronike nga sistemi elektronik i gjykatës, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për {...}ështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikave mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për {...}ështjet e zgjedhura me short.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se 5 (pesë)²¹ nga 6 (gjashtë) {...}ështjet e përzgjedhura me short, i përkasin kategorive të {...}ështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”²² dhe “Seancë paraprake”. Rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare” është 1 seancë dhe për kategorinë “Seancë paraprake” është 2.6 seanca. Në tërësi, numri mesatar i seancave gjyqësore është **1.8 seanca**.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtarja i kushton vëmendje planifikimit në kohë të {...}ështjeve, duke i vënë në lëvizje menjëherë, ose deri në 1 (një) ditë pas caktimit të {...}ështjes me short. Në vendimin e kalimit të {...}ështjes në seancë gjyqësore, gjyqtarja ka marrë masat për njoftimin në mënyrë efektive të palëve, si me fletëthirrje për palët, me shkresa drejtuar institucioneve përkatëse, apo edhe nëpërmjet mënyrave të tjera të parashikuara nga K.Pr.Civile (*në rastin e {...}ështjes me objekt lëshim i urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes*), me qëllim që të sigurojë një seancë të ardhshme efektive;
- Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t’u respektuar (si afat maksimal), rezulton që gjyqtarja e ka respektuar afatin në të gjitha rastet (*në tre {...}ështjet e kategorisë seancë paraprake, gjyqtarja për caktimin e seancës së parë gjyqësore ka respektuar afatin 5 ditor të parashikuar në nenin 329/b apo në nenin 332/1 të K.Pr.Penale, të ndryshuar*). Në {...}ështjen me objekt dërgim në gjyq, rezulton se seanca e parë gjyqësore është caktuar pas 20 (njëzet) ditësh nga dita e

²¹ Duke përjashtuar {...}ështjen me nr. 23 vendimi, datë 24.01.2019, për shkak se i përket kategorisë së {...}ështjeve pa palë kundërshtare;

²² Në kategorinë “Civile me palë kundërshtare” përfshihet vetëm dosja me nr. 973 vendimi, datë 19.12.2019 në të cilën rezulton se nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara për shkak se gjykata ka disponuar me vendim jopërfundimtar “*Kthim me të meta të padisë*”.

regjistrimit të kërkesës, në tejkalim të afatit 10 ditor të parashikuar në nenin 332/2 të K.Pr.Penale.²³ Përgjithësisht, seancat gjyqësore janë zhvilluar me afate të shkurtra kohore, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga seanca paraardhëse. Vetëm në një rast, seanca është shtyrë në një kohë relativisht të gjatë, për shkak të pushimeve vjetore në muajin gusht;

- Në të gjitha rastet, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: për njoftimin dhe marrjen dijeni në mënyrë efektive të të palëve ndërgjyqëse, për t'i dhënë mundësi palës së paditur për t'u përfaqësuar në gjykim, për t'u dhënë kohë palëve për të paraqitur prova në dobi të gjykimit, etj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për {...}do {...}është dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja në të gjitha {...}ështëjet e përzgjedhura me short e ka vënë në lëvizje dosjen po atë ditë që caktohej me cilësinë e relatores të {...}ështëjes, ose një ditë më pas. Gjyqtarja ka kryer veprimet procedurale të nevojshme për njoftimin në mënyrë efektive të të gjitha palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në dosje si: vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave paraprake, etj. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjyqtarja rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për {...}do kërkesë të palëve ndërgjyqëse, në përputhje edhe me llojin e gjykimit (*seancë paraprake apo gjykim themeli*).

Rezultoni se në {...}ështëjet e vëzhguara, seancat përgatitore dhe ato gjyqësore janë mbajtur nëpërmjet sistemit të regjistrimit audio, si dhe janë pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në {...}do rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë {...}elur me vonesa që shkojnë nga 25 minuta, deri në 2 orë e 25 minuta. Në një rast konstatohet se kjo vonesë është bërë shkak edhe për mos zhvillimin e seancës gjyqësore(*seanca e datës 06.05.2019, {...}ështëja me nr. 203 vendimi, datë 13.05.2019*).

²³ Neni 332 i K.Pr.Penale, pika 2 parashikon se “2. Nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e {...}ështëjes në gjyq, deri në datën e seancës nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë”.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efi{...}encë veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjyqimit në kohë, me efi{...}encë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 {...}ështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se dosjet janë të renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik (sipas kategorive të akteve) dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur:

- Në {...}ështjet me objekt kërkesë për dërgimin e {...}ështjes në gjyq dhe pushimin e {...}ështjes, konstatohet renditja e akteve në mënyrë kronologjike si vijon: biletë shorti, vendim për caktimin e seancës paraprake, njoftimet e palëve në procesin penal me fletëthirrje apo edhe me shkresa institucioneve përgjegjëse për njoftimin e të pandehurve, apo njoftimin e organit të akuzës, procesverbal i seancës gjyqësore, vendim përfundimtar i gjykatës, si dhe CD e regjistrimit audio të seancave gjyqësore.
- Në {...}ështjet civile konstatohet renditja e akteve në mënyrë kronologjike, si vijon: biletë e shorti, kërkesëpadi, prokura dhe provat, vendim për konstatimin e padisë me të meta, aktet e palës paditëse për plotësimin e të metave të padisë, vendimi për njoftimin e padisë palës së paditur dhe lëshimin e deklaratës së mbrojtjes, dëftesë komunikimi për vendimin e lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, vendim për kalimin e {...}ështjes në seancë përgatitore, njoftimet, procesverbali i seancës përgatitore, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimi përfundimtar të gjykatës, si dhe CD e regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit, në përputhje me veprimet procedurale të kryera nga ana e gjyqtares.

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin {...}ështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që {...}do gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe {...}do gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtares rezulton të jetë paraqitur vetëm një ankesë. Pas verifikimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.1029/3 Prot., datë 25.01.2021,²⁴ ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesës dhe rezultatit të verifikimit të saj, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

Ankesa e shtetasit Q.T., depozituar në KLGJ me nr. 2389 Prot., datë 25.04.2019, regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 1029 Prot., datë 10.06.2020, konsiston në pretendimet e ankuesit ndaj vendimmarrjes së gjyqtares, si dhe ve{...}anërisht ndaj veprimeve procedurale të gjyqtares gjatë seancës gjyqësore të datës 19.04.2019. Lidhur me këtë ankesë, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr. 1029/3 Prot., datë 25.01.2021 duke arsyetuar se: *“Nisur nga sa më lart, pretendimi i ankuesit se gjyqtare {...} {...}eka nuk ka marrë parasysh kërkesën e paditësit dhe ka vazhduar seancën gjyqësore duke shkelur kështu edhe parashikimet e ligjit procedural, nuk qëndron pasi fakti vërtetohet të jetë i kundërt me pretendimet e ankuesit, sipas dokumentacionit të paraqitur prej vetë atij. Për rrjedhojë vlerësohet se ankesa përmban elementë abuzivë, si dhe rezulton haptazi e pabazuar, duke mos u plotësuar kështu kushti i pranueshmërisë së ankesës të parashikuar nga neni 120/1 shkronja c) e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”..... Për sa më sipër, ankesa nuk plotëson kushtet për pranueshmëri të saj përse i përket natyrës së pretendimeve, një pjesë e të cilave janë haptazi të pabazuara ndërsa të tjerat nuk rezultojnë të jenë disiplinore, duke mos u plotësuar kështu kushti i pranueshmërisë së ankesës të parashikuar nga neni 120/1 shkronjat: c0, dh) të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit i ka vlerësuar shumë të larta aftësitë në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtares

²⁴ Vendimi për verifikimin e ankesës është dërguar nga ILD me shkresën me nr. 3051/2 Prot., datë 02.02.2021 dhe i përket ankesës të shtetasit Q.T.

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jetë regjistruar pranë ILD-së një ankesë, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.1029/3 Prot., datë 25.01.2021, me të cilin është vendosur arkivimi i ankesës, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e mësipërme.

Nga tërësia e faktit të parashtruar dhe të analizuar në vendimin e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.224/23 Prot., datë 30.09.2020, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me {...} është në gjykim, apo {...} do sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo të sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse

gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019–31.12.2019, janë paraqitur 9 (nëntë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 8 (tetë) kërkesa janë rrëzuar dhe 1 (një) kërkesë është pranuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 24 (njëzet e katër) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 22 (njëzet e dy) janë pranuar dhe 2 (dy) janë rrëzuar.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se rezulton vetëm një kërkesë e paraqitur dhe e pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”, ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces përdor në përgjithësi fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. I njëjti konstatim rezultojnë edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja në {...} do rast komunikojnë në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se për shkak edhe të funksionit të Kryetares, shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se për shkak edhe të karakterit dhe përvojës në punë, nuk ka patur as vështirësi dhe as problematikë për komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 4 (katër) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 4.5 ditë trajnimi.

Gjyqtarja ka marrë pjesë në 4 aktivitete trajnuese të shtrira në 4.5 ditë trajnimi, nën kufirin minimal (5 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese.

***Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është nën kufirin minimal 5 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019,) duke e pikëzuar me 4 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtarja {...}, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, nuk është ftuar për të marrë pjesë në cilësinë e lehtësuese/ekspertes në aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e saj në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtar gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtares, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtares, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.{...} Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me zero pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
75	Shumë mirë

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR {...}DO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer, pasqyrohet niveli i vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit të gjyqtarës.

Niveli e vlerësimi për {...}do kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	75	Shumë mirë
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	371	Shumë mirë

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “{...}”, të ligjit nr. 96/2016, “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe të vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} në pjesën e vendimit ku pasqyrohet trupi gjykues të vendosë vetëm mbiemrin “Xhili”, të përdorë gjithmonë të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (ë dhe {...}) në vendimet gjyqësore, të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitetet për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e {...}ështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e {...}ështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet {...}do {...}ështëje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të {...}ështëjeve
	{...}. Rendimenti i përfundimit të {...}ështëjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të {...}ështëjeve
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për {...}do {...}ështëje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i	Shumë e lartë

		kryetarit	
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i
---------	--------	-----------------------------

			treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja 	<5 ose >40 ditë (Periudha 1/vje {...} are)
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera 	Nuk ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. {...} do e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtares 	Nuk ka të dhëna
	{...}. Publikimet ligjore akademike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dosja personale e gjyqtares 2. {...} do e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj 	Nuk ka të dhëna

PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT	
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES	Shu